

BARDHYL DEMIRAJ

**MARTIN CAMAJ DHE DEGA E ALBANOLOGJISË
NË UNIVERSITETIN LUDWIG-MAXIMILIAN TË MYNIHUT**

Më duhet fillimisht të falënderoj organizatorët e tubimit që i krijuan hapësirë kumtesës sime në sesionin e dytë, të menduar si të gjuhësisë. Është pikërisht kjo fushë, që së bashku me filologjinë dhe kulturën e shkrimit shqip zënë vend qendror në programin universitar dhe kërkimin shkencor të degës së albanologjisë në universitetin elitar Ludwig-Maximilian të Mynihut. Lëmenj të tjerë, si: letërsi, kulturë popullore dhe antropologji historike e sociale janë konsoliduar gjithashtu në program, duke ravijëzuar kështu konturet e një shkence rajonale në sistemin universitar gjerman.

Statusi institucional i degës është të përgatisë, të diplomojë dhe të doktorojë si albanologë të rinj ata studentë e studiues që përzgjedhin albanologjinë si degë kryesore studimi; përkatësisht të plotësojë formimin universitar dhe pasuniversitar të atyre studentëve që marrin albanologjinë si degë plotësuese. Ky status ruhet ende sot i akredituar në matriksin e sistemit universitar tradicional gjerman, çka e bën këtë degë të jetë unike në gjithë atë pjesë të arealit shkencor albanologjik që shtrihet jashtë hapësirës kompakte shqipfolëse në Ballkan.

Lejohem të bëj që në fillim përjasje të kësaj natyre, në mënyrë që shumëkush në auditor të krijojë një imazh të saktë për rolin e atij që mundësoi përfundimin e kësaj dege në Universitetin e Mynihut, si edhe për vetë vendin e degës në rrjetin institucional ndërkombëtar të shkencave albanologjike prej gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Dhe është fakt që ngjizja, konsolidimi dhe vazhdimësia e kësaj dege si qendër e mirëfilltë shkencore dhe universitare në Mynih është fryt i angazhimit profesional dhe social të Martin Camajt, i cili i përkushtoi asaj 30 vjetët më të frytshëm të jetës së tij akademike.

Karrierën akademike dhe profesionale të Martin Camajt në Mynih mund ta përmbledh shkurt në tri faza e me disa stacione në secilën syresh¹:

¹ Të dhënat e mëposhtme bazohen në materialin dokumentar që ndodhet në arkivin e familjes Camaj (Lenggries) si edhe në dosjen “Camaj” të arshivuar pranë arkivit të Universitetit Ludwig-Maximilian të Mynihut. Më hollësisht për jetën

1. *Si bursist*

- Janar – tetor 1961: bursist i fondacionit DAAD pranë Seminarit të dikurshëm të Gjuhësisë në Universitetin Ludwig Maximilian të Mynihut

- Mars 1962 – janar 1965: bursist i fondacionit DFG, me synim paraprak kryerjen e doktoraturës së shkallës së dytë, d.m.th. të habilitacionit

2. *Si docent privat*

- 21 janar 1965: Camaj është habilituar ndërkohë dhe fiton zyrtarisht statusin e docentit privat me të drejtën për të mbajtur lëndë universitare në fushë të albanologjisë,

- 1 qershor 1965: Camaj punësohet në universitet me kontrata vjetore si punonjës shkencor i shkallës së parë,

- 15 maj 1970: Camaj punësohet si “docent universiteti për albanologji” me marrëdhënie punësimi në provë.

3. *Si profesor universiteti*

- 16 korrik 1971: Camaj emërohet “profesor joordinar në albanologji”,

- 14 shtator 1978: Camaj merr emërimin zyrtar “profesor ordinar në albanologji” me marrëdhënie punësimi të përhershme,

- Më 30 shtator 1990 bursisti i dikurshëm Camaj mbyll zyrtarisht karrierën e vet akademike 30-vjeçare si profesor universiteti, duke lënë pas një traditë të mirë universitare në lëmin e albanologjisë.

Këto të dhëna na japin informacion kryesisht për karrierën profesionale të Martin Camajt si komponente e rëndësishme e aktivitetit të tij të mirëfilltë shkencor-intelektual. Për një përshkrim të detajuar të historisë së brendshme të degës, fiton më fort rëndësi një paketë tjetër të dhënash informative, në të cilat fiks rishtas emri i Martin Camajt; ndër to dallojmë:

- Semestri i verës 1961: Camaj fillon të japë vullnetarisht 2 orë në javë mësim shqip. Krijohet kështu një nyjë e re në rrjetin ndërkombëtar albanologjik, sikurse edhe në sistemin universitar gjerman. Me statusin e një lektori pa pagesë Camaj do të vijojë të japë mësim shqip 4 vjet me radhë në këtë universitet (deri në semestrin e dimrit 1964/65).

- Semestri i verës 1965: doktori i habilituar Camaj ka fituar ndërkohë të drejtën për të mbajtur leksione dhe seminare në albanologji. Dhe ai e shfrytëzon këtë status duke përgatitur një program universitar joshës për

akademike të Martin Camajt shih Bardhyl Demiraj: Jeta akademike e Martin Camajt, në aktet e konferencës “Martin Camaj – shkrimtari dhe albanologu”, Shkodër, më 26 korrik 2010 (në shtyp).

studentë të degëve të ndryshme gjuhësore, të tilla si: gjuhësi e përgjithshme dhe indoeuropianistikë, sllavistikë, romanistikë etj.

- Semestri i dimrit 1971/2: Camaj merr postin e ri të profesorit joordinar në albanologji dhe e zgjeron më tej paletën e programit universitar duke e përcjellë albanologjinë si shkencë komplekse me karakter ndërdisiplinor, në mënyrë që të nxisë interesimin edhe për studentë të shkencave jogjuhësore, si historia, etnografia etj.

- Semestri i dimrit 1978/9: Emërimi i Camajt si profesor ordinar shënon njëherësh konsolidimin e albanologjisë si degë e veçantë studimi në sistemin universitar gjerman. Albanologjia në Mynih ngërthehet kështu në rrjetin ndërkombëtar albanologjik si qendër universitare e shkencore duke ofruar mundësi specializimi të mirëfilltë në gjuhësi.

- 16 nëntor 1989: senati i Universitetit të Mynihut në mbledhjen e tij të radhës miraton shpalljen e vendit të profesurës ordinare në albanologji (pasues i Martin Camajt), çka do të thotë njëherësh sigurim i vazhdimësisë së degës së albanologjisë në Universitetin e Mynihut.

E kam veçuar këtë grup të dytë të dhënash informative, me mendimin se kemi të bëjmë këtu me disa pika orientuese lidhur me njohjen e një aspekti të veçantë në jetën akademike të Martin Camajt; është pikërisht angazhimi i tij social, si kut matës për prurjet e tij në rrjetin ndërkombëtar të shkencave albanologjike. Kemi të bëjmë këtu me një dhunti të karakterit dhe sjelljes së tij sociale, së cilës dashur pa dashur i ka anashkuar gjithë ajo mori artikujsh divulgativë në mediet shqiptare, apo ajo dënduri studimesh dhe esesh, që fokusohen kryesisht në aktivitetin individual intelektual të Camajt, si shkrimtari më i spikatur në letërsinë e mërgatës shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, apo si studiuesi albanolog që guxoi në disa fusha të gjuhësisë, me sukses në filologji dhe kulturën e shkrimit shqip e që vuri bazat e dialektologjisë moderne arbëreshe.

Duke tematizuar veprimtarinë apo angazhimin social të Camajt, shpresoj të mos u bie ndesh në asnjë rast atyre shkrimeve gjoja “të qëlluara”, që e prezantojnë Camajn si shqiptarin e mbyllur, krejtësisht të mohuar dhe të izoluar prej mjedisit, të cilit i takonte; si një Robinson që e kishte bërë gjuhën vet – gegërishten – “atdhe dhe shtëpi”, apo një Drane me atdhe portativ, që kërkoi dhe gjeti prehje diku rrëzë Alpeve të Evropës, nga ku mund të kundronte gurët e gërxhet e mjedisit përreth e të sillte ndërmend vendlindjen, Temalin dhe Dukagjinin.

Në rast se gjurmojmë hap pas hapi ecurinë e bursistit, docentit dhe profesorit Camaj gjatë angazhimit të tij social dhe profesional, ne do të përballemi me një tjetër Martin; pikërisht a) me Martinin vital dhe aktiv,

që kërkon dhe gjen në Mynih ato rrethe shkencore-intelektuale, që interesohen për hapësirën gjuhësore-kulturore të Ballkanit Perëndimor; b) me Martinin bursist që integrohet shpejt në jetën universitare dhe në programin universitar që ofronte atëherë Seminari i Gjuhësisë, madje ndikon vullnetarisht në larminë dhe pasurimin e tij; c) me Camajn docent dhe profesor që përsiat dhe sendërton një program të plotë universitar për një degë gjermëatëherë “të pazakonshme”, duke e shndërruar atë hap pas hapi – por me vetëdije – në një shkencë rajonale ndërdisiplinore; për më tepër d) do të njohim një Camaj që vendos dhe përkujdes marrëdhënie të mira kolegjiale brenda dhe jashtë universitetit, e që organizon me kolegë të ndryshëm programe të përbashkëta universitare; si edhe e) një Camaj që bashkëpunon intensivisht me qendra të tjera albanologjike në Europë dhe SHBA, veç atyre në hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan.

Mua më është dashur të gjurmoj dikur nga afër pikërisht këtë aspekt të jetës akademike të Martin Camajt, ndër tjera, sepse kam dashur të përditësohem me rrugën e përfuturit dhe të konsolidimit institucional të degës së albanologjisë në Mynih e për më tepër të njoh strategjinë e syzuar dikur prej tij për të siguruar vazhdimësinë e profesurës, d.m.th. të degës së albanologjisë në këtë universitet. Lejohem ta theksoj këtë detaj të fundit, sepse ngadhnjimi i profesurës për albanologji hapi në fakt mundësi të mëdha, por nxori në pah edhe probleme jo të vogla, me të cilat Camaj do të përballlej gjatë gjithë karrierës së tij profesionale e të cilat i kanë trashëguar sipas rastit edhe pasardhësit e radhës. Ndër to veçoj si më të vështirat:

- përballjen e përhershme me degët universitare të ashtuquajtura të mëdha, me ato që – siç dihet – kërkojnë dhe marrin gjithëherë hisen e luanit; por jo më pak,

- me fushatat e herëpashershme dhe destruktive që kryhen shpesh në kuadër të “kursimit” dhe të “reformës”, nocione këto në thelb pozitive, por që – siç i përjetojmë sot e gjithë ditën – me efekte negative largvajtëse kryesisht për degët universitare të ashtuquajtura të vogla, - me mospërfilljen proverbiale të politikës shqiptare në kohë dhe hapësirë.

“Kam pasë shumë të çame kreje edhe në çashtje të katedrës së albanologjisë, – i shkruan Camaj një miku në vitin 1981 –, mbasi ishte *ad personam* e unë dosha kontinuitetin. Ka njerëz që kam pregatitë me vjet dhe janë në gjendje me ba punë të mëdha. Tash për tash asht sigurue ekzistenca, por ligjëet dhe sistemet universitare janë tue ndërrue dita-ditës: gjithkund kursime prej kah rrjedh mandej edhe prioriteti i dishiplinave (Fächer). Albanologjia, thonë këta edhe ndër sy, e mbramja birë e kavallit. Po, disesi shpresoj se ndreqet puna, përndryshej pa sigurinë e kontinuitetit

jam i paralizuem e nuk mund të zhvillohen programe afatgjata. Këto janë vështirësitë që më kanë lodhë ma tepër se puna në vetvete.”

Janë pikërisht këto vështirësi e lodhje që shoqëruan jetën e tij akademike për 30 vjet me radhë, e që nuk mund të mos linin pasoja edhe në shëndetin e tij. Megjithatë Camaj arriti të paktën të përjetojë e të gëzojë vazhdimësinë e ngrehinës së vet.

“Vazhdimësia e albanologjisë në Mynih u sigurua, – i shkruan Camaj më 8. prill 1989 mikut të tij, albanologut Herman Ölberg – Ju e dini se çfarë statusi ka këtu kjo degë, megjithatë po hyj në hollësi:

Albanologjia bën pjesë te degët e vogla, por me statusin e një specialiteti të mirëfilltë universitar në studim dhe kërkim shkencor: a) sektor i veçantë brenda institutit, b) kombinim me degët filologjike për gjuhë dhe letërsi; duke parapëlqyer në kombinim si fushë kryesore gjuhësinë; c) degën e albanologjisë mund ta përfundosh me gradën akademike të magjistrisë dhe të doktorit; çka nuk ishte aspak e lehtë. Në këtë mënyrë është arritur pavarësia e plotë e degës; c) profesura është C 3 (C 4 janë ata, që emërohen së jashtmi si drejtues institutesh; së paku kështu në Mynih).

Unë jam përpjekur ta konsolidoj degën me një program ndërdisiplinor, dhe ia dola mbanë.”²

Si ia doli mbanë Camaj i vetëm të organizonte degën e albanologjisë si fushë ndërdisiplinore, e për më tepër të siguronte vazhdimësinë e saj? Një pyetje kapitale, që nuk është shtruar ende si e tillë. Camaj nuk duhet të ketë qenë tipi i atyre që dinë të bëjnë miq për të ndërhyrë dikur për ta; nuk ishte tipi i atyre që dinë “të bëjnë lobizëm”, term që e dëgjojmë sot dendur ndër politikanët tanë. Në korrespondencën e tij – që shpresoj ta njoh jo pak –, nuk kam ndeshur deri sot asnjë rast, ku Camaj t’i drejtohet dikujt për të ndërhyrë me emrin e tij për diçka, edhe pse në letrat e tij dalin jo pak emra

² “Die Kontinuität der Albanologie in München ist gesichert. Sie kennen was für einen Status hier dieses Fach hat, trotzdem gehe ich die Einzelheiten: die Albanologie gehört zu den kleinen Fächern, aber den Status einer vollständigen Universitätsspezialität in Lehre und Forschung: a) selbständige Abteilung innerhalb eines Instituts, b) Kombination mit philologischen Fächern für Sprache und Literatur, Schwerpunkt wird die Linguistik bevorzugt als Kombination; c) im Fach Albanologie kann man Magister und Doktorgrad erwerben, was nicht einfach war. So ist die Unabhängigkeit vollständig; d) die Professur ist C3 (C4 sind diejenigen, die von außerhalb als Vorstände der Institute berufen werden, zumal so in München). Ich habe versucht, das Fach interdisziplinär zu festigen und ist gut gelungen. ...” (Lenggries, 8.4.1989 – fondi i Arkivit të familjes Camaj)

personalitetesh të politikës së Bavarisë. Këto rrethana na përforcojnë edhe më shumë bindjen, se ishte pikërisht angazhimi social për 30 vjet me radhë i bursistit, i docentit dhe i profesorit Martin Camaj që bëri të nevojshëm dhe të domosdoshëm përfitim, konsolidimin dhe vazhdimësinë e degës së albanologjisë në Universitetin tashmë elitar të Mynihut. Prandaj gëzon dhe do të gëzojë tek ne gjithherë respekt dhe nderim të veçantë.